



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së tetë të Kuvendit të Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, mbajtur më
27.10.2022, e cila filloi në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Nora Kelmendi (LVV), Arbër Vokrri (LVV), Arianit Beqiri (LVV), Ermal Osmani (LVV), Feim Osmani (LVV), Gëzim Sveçla (LVV), Rashit Gashi (LVV), Petrit Reçica (LVV), Mirsad Vitija (LVV), Besnik Mujeci (LVV), Violeta Salihu (LVV), Besart Krasniqi (LVV), Rita Zeqiri (LVV), Tiera Kasumi-Berisha (LVV), Berna Saraçi (LVV), Arbnora Berisha (LVV), Fehmi Kupina (LDK), Sami Salihu (LDK), Pëllumb Bajqinovci (LDK), Jeta Rafuna-Hasani (LDK), Ajet Brajshori (LDK), Dasmor Durmishi (LDK), Milazim Vitija (LDK), Amir Simnica (LDK), Driton Rukiqi (LDK), Hafiz Krasniqi (LDK), Dhurata Jahaj-Retkoceri (LDK), Lindita Rexhepi (LDK), Donjeta Dragusha (LDK), Elmire Nikçi-Rexha (LDK), Fiknete Bejta (LDK), Granit Geci (PDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Muhamet Selmani (PDK), Agron Canolli (PDK), Arbnora Ajeti (PDK), Fatmir Dervishi, (PDK), Kumrije Shabani-Ramadani (PDK), Shegë Beqiri-Badivuku (PDK), Gresa Lahu (PDK), Endrit Gashi (AAK), Kushtrim Mushica (AAK), Taulant Maxharraj (AAK), Valbona Ajeti (AAK), Sami Boroci (AKR), Gëzim Mehmeti (AKR), Endrit Zabërgja, (NISMA) dhe Agim Kuleta (LB).

Munguan: Berat Lahu (LVV), Liridon Selmani, (PDK) dhe Bahri Gashi (AAK).

Të pranishëm ishin edhe: Përparim Rama, kryetar i Komunës, Alban Zogaj, nënkryetar, Donjeta Sahatçiu, nënkryetare e Komunës, Bersant Beka, drejtor i Drejtorisë së Administratës, Donat Lushaku, drejtor i Drejtorisë së Kadastrit, Mimoza Sylejmani, drejtore e Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Arbër Sadiki, drejtor i Urbanizmit, Ilirik Musliu, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Adelina Sahiti, drejtore e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale, Granit Rugova, drejtor i Drejtorisë së Sportit, Besianë Musmurati, drejtore e Drejtorisë së Arsimit, Izet Sadiku, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë, Doruntinë Maloku, drejtore e Drejtorisë së Pronës, Plator Gërdovci, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë, Krenar Xhaferi, drejtor i Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, Valbona Makolli, drejtore e Drejtorisë së Financave, përfaqësues të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve dhe përfaqësues të medieve.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Fehmi Kupina**, kryesues i Kuvendit.
Kryesuesi hapi diskutimin për rendin e ditës.

Gëzim Sveçla fillimisht bëri vërejtje rreth mos kompletimit të materialeve me kohë, që do të thotë se nuk po përfillen procedurat e parapara ligjore. Po ashtu, propozoi që në rend të ditës të futet edhe pikat: "Diskutim mbi situatën aktuale në Ndërmarrjen Publike Banesore", projekti lagjja "Lakërishte", ndërrimi pikave të rendit të ditës, që pika "Pyetje dhe përgjigje" dhe "Të ndryshme", të fuzionohen në një pikë të vetme dhe të jetë pika e dytë e rendit të ditës", dhe "Anulimi i Vendimit në lidhje me shujtat e punëtorëve".

Kryesuesi i hodhi në votim propozimet e z. Sveçla.

Kryesuesi konstatoi se më 18 vota për dhe 26 kundër, nuk u miratua propozimi "Diskutimi mbi situatën aktuale në Ndërmarrjes Publike Banesore", "Projekti në lagjen Lakërishta", dhe nuk futen në rend të ditës për diskutim.

Kryesuesi konstatoi se më 15 vota për dhe 25 kundër, nuk u miratua propozimi që pikat "Pyetje dhe përgjigje" dhe "Të ndryshme" të fuzionohen në një pikë të vetme dhe të dalin si pikë e dytë e rendit të ditës, nuk futen në rend të ditës për diskutim.

Kryesuesi konstatoi se më 16 vota për, 24 kundër dhe 2 abstenime, nuk u miratua propozimi që "Propozimvendimi për anulimin e Vendimit të shujtave", dhe nuk futet në rend të ditës për diskutim.

Kryesuesi konstatoi se më 27 vota për dhe 15 kundër, u miratua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së shtatë të Kuvendit të Kryeqytetit;
2. Raporti financiar buxhetore i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 korrik - 30 shtator 2022 (TM3);
3. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale, me pronën e paluajtshme në pronësi të "Kompania e Re Dardania - Arbëria" SHPK (qirambajtje), Rizah, Metush, Bekim, Bashkim dhe Artin Deshishku;
4. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale, me pronën e paluajtshme në pronësi të "Pozhegu Brothers" SHPK;
5. Propozimvendimi për caktimin e komisionit për udhëheqjen dhe koordinimin e punës në terren për përzgjedhjen e këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane;
6. Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve financiare për NPL "Kuzhina Qendrore";

7. Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve financiare për NPL "Hortikultura";
8. Informatë lidhur me Raportin vjetor të komisionit të aksionarëve të NPL "Pallati i Rinisë";
9. Informatë lidhur me Raportin vjetor të komisionit të aksionarëve të NPL "Hortikultura";
10. Pyetje dhe përgjigje;
11. Të ndryshme.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së shtatë të Kuvendit të Kryeqytetit

Fiknete Bejta bëri vërejtje në ekstrakt, e cila tha se origjinal qysh e flasim gjuhën ashtu të na e shkruajnë.

Kryesuesi konstatoi se më 27 vota për dhe 2 kundër, u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së shtatë të Kuvendit të Kryeqytetit.

Pika e dytë

Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 korrik - 30 shtator, 2022 (TM3).

Lidhur me Raportin financiar buxhetor të Komunës së Prishtinës për periudhën 1 korrik - 30 shtator, 2022 (TM3), të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Valbona Makolli, drejtoreshë.

Mirsad Vitija tha se në këtë raport shohim se kemi rënie të të hyrave vetanake prej 30.75% në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraparak, apo të hyrat vetanake më të ulëta në 3 vitet e fundit. Kemi më pak të hyra nga tatimi në pronën e paluajtshme, taksa për transaksion në pronë, taksa për certifikata dhe dokumente zyrtare, infrastruktura rrugore, mbeturinat etj., ndërsa sa i përket shpenzimeve buxhetore Komuna është efikase dhe shpesh i rritë ato në kategoritë, si: "mallra dhe shërbime", "komunale" dhe "subvencione e transfere".

Komuna e Prishtinës gjatë periudhës janar - shtator 2022, nga gjithsej buxheti prej mbi 127 milionë euro, ka shpenzuar vetëm 51 milionë, që do të thotë se realizimi i buxhetit për 9 muaj është diku rreth 40%. Kjo gjendje e rëndë na tregon se Komuna jonë me shumë gjasa do ta mbyll vitin me suficitin më të lartë ndonjëherë në historinë e saj. Për ta kuptuar se pse kemi një gjendje të tillë, kjo më së miri reflektohet në drejtoritë përkatëse se si e kanë shpenzuar buxhetin e tyre për projekte kapitale.

Jeta Rafuna tha se qeverisja e kryetarit Rama ka marrë një kahe shumë dinamike duke bërë planifikime të sakta të projekteve dhe duke u kujdesur që të jetësohen ato, gjë që nuk pasqyrohen në shifrat e këtij raporti si rezultat i planifikimit të dobët. Sa i përket shpenzimeve kapitale të cilat shihen se nuk kanë realizim të kënaqshëm, pasi që rritja e madhe e çmimeve dhe mos subvencionimi i kontratave, ka krijuar kaos në të

gjitha kontratat publike, e këtë ka mundur ta rregullojë vetëm Qeveria e Kosovës me vendimin për subvencionimin e kontratave, e që një vendim të tillë nuk ka arritur ta bëjë tani që jemi në prag të fundit të vitit.

Kryetari dhe ekzekutivi me gjithë vështirësitë që janë ballafaquar, kanë pasur dinamikë të madhe të punës, kanë bërë plane urgjente që të realizojnë plane dhe projekte, dhe qytetarët e Prishtinës çdo ditë e më shumë po e vërejnë ndryshimin që ka ndodhur në Prishtinë.

Shegë Beqiri tha se ky raport shpalos punën e gjithë ekzekutivit, gjithashtu shpërfaqë transparencën dhe llogaridhënien e plotë financiare, të arriturat e deri tek mangësitë në rezultatet që mund t'i ketë ky raport. Të hyrat vetanake të Komunës gjatë 3-mujorit të tretë janë arkëtuar në vlerën e përgjithshme vjetore 21.27%, ndërsa kanë shënuar një rënie prej 30.75% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Sa i përket kësaj pike, të gjithë ata që e kemi lexuar këtë raport, e keni parë që tregohet edhe arsyeja pse është kjo rënie në krahasim me vitin paraprak. Kjo vjen si pasojë e grevës së përgjithshme të Administratës komunale, ku sektorët kyç nga Drejtoria e Financave, Urbanizmit e deri tek ajo e Pronës, nuk kanë pasur mundësi të arkëtojnë pagesa në këtë periudhë.

Shpenzimet buxhetore janë 9.53% më shumë krahasuar me shpenzimet e realizuara gjatë periudhës së njëjtë të vitit paraprak. Këto shpenzime buxhetore janë edhe për t'u përshëndetur në shumicën e drejtorive, sidomos tek kategoria e subvencioneve ku preket në mënyrë të drejtpërdrejtë qytetari.

Gëzim Mehmeti tha se kur e kemi një situatë të tillë, e që ka të bëjë me qytetin e Prishtinës, ka të bëjë me realizimin e buxhetit, për të cilin ne në një formë edhe jemi përgjegjës, kështu që qytetarët e Prishtinës nuk na kanë zgjedhur të merremi më çështje madhore, të jemi kompetencë e Parlamentit të Kosovës, por na kanë zgjedhur për problemet që kanë të bëjnë me qytetin e Prishtinës.

Ai ka kërkuar nga kryetari që të merret më shumë me çështje të realizimit të buxhetit. **Feim Osmani** tha se nga parafolësit u dhanë vërejtje përgjithësisht të shpenzimet e buxhetit që janë vërejtje me bazë, edhe pse performanca është e dobët, mirëpo e njëjta performancë për afërsisht është edhe te të hyrat.

Kuvendi i ka dhënë mandat kësaj qeverie me i shpenzuar ose me investuar 47 milionë euro që kanë qenë të bartura, mirëpo edhe pjesën tjetër që ka qenë e keqplanifikuar nga qeveria e kaluar.

Konsideroj se si çështje tejet shqetësuese është rritja e shpenzimeve për "komunale", që është 36.28% më e madhe krahasuar më vitin 2021, andaj dhe për këtë shqetësim kisha dashur një përgjigje.

Arjanit Beqiri thash paraprakisht se është dashtë që të diskutohet edhe për Ndërmarrjen Publike Banesore, pasi që është konstatuar se aty janë duke u tjetërsua 17 mijë metra katrorë në qendër të qytetit, prandaj dhe është shumë e rëndësishme, për shkak se çdo performancë të cilën e flasim qoftë edhe kjo pasqyra buxhetore, është e rëndësishme, për shkak se ndërmarrjet janë pjesë dhe janë aktorë shumë të rëndësishëm të kësaj qeverisjeje.

Triera Kasumi-Berisha tha se sa i përket raportit tremujor, në veçanti do të fokusohem te raporti i detyrimeve kontingjente nga Zyra e përfaqësimit juridik për periudhën janar-shtator, për të cilën e vlerësoj që jo krejt lista është e saktë dhe është transparente, d.m.th. vlera e lëndëve që figuron si shpenzime kontingjente, është vlerë që palët paditëse e kërkojnë nga Komuna.

Kjo varet edhe nga aftësitë dhe vullneti i përfaqësuesve ligjorë të Komunës, në këtë raport i cili na është servuar neve, pra janë dy lëndë të listuara të cilat tash më janë të fituara në gjykatë edhe shumat nuk duhet llogaritur si kontingjente. Po ashtu, për dy konteste milionëshe, lëndët që kanë qenë në gjykatë, d.m.th. nuk ka vendim të gjykatës, mirëpo në bazë të provave të cilat unë i kam siguruar, lënda me kontest gjyqësor prej 5 milion e 370 mijë euro, është pronë e shpronësuar nga vitet e 40-ta. Gjithashtu, ka edhe lëndë të tjera dhe paditës të cilët kërkojnë kompensime të dëmeve, shtëpive të dëmtuara gjatë luftës, e që gjykata këto lëndë as që i merr parasysht, sepse nuk janë kompetencë e Komunës. Ju lutem që këto lëndë të largohen nga lista dhe detyrimet kontingjente, sepse nuk po e kemi një pasqyrim real.

Gëzim Sveçla tha se është tendencë e vazhdueshme që fajin me e bartur te institucionet qendrore, e kjo paraqet përtej të gjithave, vetëm mungesë të vizionit. Po flasim për çështjet që kanë të bëjnë me inflacionin ndërkombëtar, ndërkohë që barrën dhe përgjegjësinë e drejtoni te niveli qendror. Këto vështirësi nuk janë të shkaktuara as nga niveli qendror, as nga niveli lokal, është problem global, por tendenca është me bartur fajin edhe përgjegjësinë te dikush tjetër, e kjo paraqet veçse papërgjegjësi, mungesë vizioni edhe dembeli e asgjë tjetër.

Fiknete Bejta tha se njëra prej shkaqeve të mos realizimit të projekteve, ka qenë mos funksionimi i OSHP-së, si dhe problemi i inflacionit, ngritja e vazhdueshme e çmimeve. Rritja e komunaleve ndodh për shkak të rritjes së çmimeve, paguhen kostoja e energjisë, ujit dhe shërbimeve tjera që njihen si shpenzime të komunales. Pastaj po ngrihet si shqetësim problemi i konkurseve për pozitat e larta në ndërmarrjet publike, konkurset kanë qenë publike dhe janë zbatuar të gjitha.

Për konkurset e tilla, nuk e di që ka pasur ndonjë ankesë në inspektorat, d.m.th. procedurat kanë qenë shumë të qarta, transparente dhe kanë qenë aq publike sa ne e dimë poentimin e kandidatëve. Unë ju inkurajoj që në ndërmarrjet lokale të konkurrojnë të gjithë ata që i plotësojnë kushtet.

Hafiz Krasniqi vlerësoi se është një raport gjithëpërfshirës, që përpos anës ligjore që është i caktuar sipas Ministrisë së Financave, ka dhënë edhe sqarime për të gjitha komponentët të cilët e përcaktojnë performancën e një raporti. E përgëzoj për këtë edhe drejtoreshën, por njëkohësisht edhe drejtorët të cilët kanë ofruar punët dhe veprimet e tyre.

Donjeta Dragusha theksoi se kriza ekonomike dhe ngritja e çmimeve ka ndikuar në të gjitha komunat. Është detyrë e nivelit qendror, saktësisht e qeverisë, që të ndikojë dhe t'i ndihmojë të gjitha komunat, e që mendoj se është vonuar shumë në përpilimin e ligjit për subvencionimin e kontratave, e që ndoshta procedurë më e shpejtë për me iu ndihmuar komunave në këtë çështje do të ishte vetëm plotësim-ndryshimi i përkohshëm i Ligjit të prokurimit. Një çështje tjetër që desha me u ndërlidhur, është te raportimi i ndërmarrjeve

Publike, siç po e quajmë, tani nuk është koha e raportimeve, raportimet zakonisht bëhen pas mbylljes së vitit fiskal dhe atëherë do të raportojmë.

Për vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna nga parafolësit, sqarime shtesë dhanë Përparim Rama, Rizah, Metush, Bekim, Bashkim dhe Artin Deshishku.

U konstatua se u përkrah Raporti financiarë buxhetore i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 korrik - 30 shtator 2022 (TM3).

Pika e tretë

Propozimvënimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale, me pronën e paluajtshme në pronësi të "Kompania e Re Dardania- Arbëria" SHPK (qirambajtje), Rizah, Metush, Bekim, Bashkim dhe Artin Deshishku.

Lidhur me Propozimvënimin për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të "Kompania e Re Dardania- Arbëria" SHPK (qirambajtje), Rizah, Metush, Bekim, Bashkim dhe Artin Deshishku, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Doruntinë Maloku, drejtore.

Nora Kelmendi, lidhur me këtë propozimvendim ngriti shqetësim, duke cekur se në dokumentacion mungon sipërfaqja me metër katrorë, prandaj është dashtë që të jenë të përcaktuara në atë sipërfaqe.

Jeta Rafuna tha se si GP këtë propozimvendim e përkrahim për miratim.

Leutrim Retkoceri u shpreh se sa i përket kësaj pike, ne si GP i kemi kërkuar sqarime dhe i kemi dhënë edhe disa vërejtje në mbledhjen e Komitetin për Politikë dhe Financa, kështu që për neve mbetet qëndrimi që e kemi dhënë në mbledhjen e komitetit.

Gëzim Mehmeti shprehu mendimin se ky propozimvendim duhet të plotësohet edhe më tej, prandaj kërkoj që të kthehet, të rregullohet, të definohen saktë metrat katrorë e më pas të silllet për diskutim.

Petrit Reçica, lidhur me këtë propozimvendim ngriti shqetësim, duke thënë se çka do të ndodhë me tulltoren pas përfundimit të Manifestës, cili është statusi i saj, tash po i merret një pjesë e hapësirës me këtë shkëmbim, a mundemi veç me dit statusin e saj.

Gëzim Sveçla ngriti shqetësim rreth këtij propozimvendimi, duke shtuar se po na kërkonim me votuar diçka për çka nuk jemi në dijeni, vetëm po votojmë një hapësirë, e sa duhet me dhënë nuk po e dimë. Konsideroj se me të vërtetë kjo nuk ka kurrfarë logjike, është non sens, e pakuptimtë, prandaj me sinjoretin më të madh u bëj ftesë të gjithë kolegëve asambleistë të të gjitha subjekteve që mos me ra pre e kësaj, është më të vërtet nënvlersim për neve.

Agim Kuleta tha se proceduralisht ekzekutivi bjen vendime në Kuvend, diskutohen, përmisohen edhe votohen. Këtu nuk kishte diçka një gabim të madh ose një ndryshim të madh, ose një mungesë të një dokumenti, i cili kërkon që ky propozimvendim të shtyhet për një seancë tjetër.

Muhamet Selmani tha se paraprakisht është dashur të bëhet vlerësimi i këtyre pronave, pra është e vërtetë që në rastet e vlerësimit të pronave ne kemi me pasur pa marrë parasysh që janë të njëjtën zonë, mundemi me pas vlerësimet të ndryshme. Një ndër faktorët kryesor është edhe pozicioni i parcelës që jep një vlerësim ose një pikë pozitive më shumë në vlerësimin e pronës, sepse kjo mund të rezultojë me një vlerësim më të lartë.

Arbër Vokrri tha se nga përvoja e deritashme në këtë Kuvend komunal, por edhe nga ato Kuvendet komunale që vinë në Ministri, kur janë treguar skicat ortografike për çështje si kjo këmbim të parcelave - shpronësim ose diçka, gjithmonë ka qenë e shoqëruar me numra qoftë për sipërfaqen e metrave katrorë, qoftë për vlerën e saj, kështu që kisha lutur që të mos na sillet prap në votim, ndoshta me korigju këtë në një afatë tjetër mandej ta votojmë.

Lidhur me vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna nga parafolësit, sqarime shtesë dhanë Përparim Rama, kryetar, Arbër Sadiki, drejtor dhe Doruntinë Maloku, drejtore.

Kryesuesi konstatoi se më 20 vota për, 11 kundër dhe 2 abstenim, u miratua Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të "Kompania e Re Dardania- Arbëri", SHPK, (qirambajtje), Rizah, Metush, Bekim, Bashkim dhe Artin Deshishku.

Pika e katërt

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të "Pozhegu Brothers", SHPK.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Doruntinë Maloku, drejtore.

Nora Kelmendi bëri vërejtje rreth këtij propozimvendimi, duke thënë se sipas legjislacionit në fuqi, certifikata e pronës duhet të jetë jo më e vjetër se gjashtë muaj për pronat të cilat janë objekt i këmbimit, mungon certifikata e pronës dhe kopja e planit, të cilat duhet të jenë me afat gjashtëmuajor.

Gëzim Sveçla tha se përderisa nuk plotësohen kushtet ligjore për një këmbim të tillë, rrjedhimisht nuk mundemi të votojmë kundër legjislacionit në fuqi.

Kryesuesi konstatoi se më 24 vota për, 10 kundër dhe 2 abstenime, u miratua Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale, me pronën e paluajtshme në pronësi të "Pozhegu Brothers", SHPK.

Pika e pestë

Propozimvendimi për caktimin e komisionit për udhëheqjen dhe koordinimin e punës në terren për përzgjedhjen e këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane.

Lidhur me Propozimvendimin për caktimin e komisionit për udhëheqjen dhe koordinimin e punës në terren për përzgjedhjen e këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Bersant Beka, drejtor.

Gëzim Sveçla tha se për hir të opinionit dhe të asamblistëve të tjerë që nuk janë pjesë e KFP-së, me e pasur parasysh e me ditur si është zgjedhur përfaqësuesja e Shoqërisë civile, në ndërkohë që prej grupit tonë - LVV-së, për anëtar të komisionit është propozuar Feim Osmani.

Donjeta Dragusha, për anëtar të komisionit nga Grupi i LDK-së propozojmë Jeta Rafunën.

Shegë Beqiri, për anëtar të komisionit nga Grupi i PDK-së, propozojmë Leutrim Retkocerin.

Taulant Maxharraj, për anëtar të komisionit nga Grupi i AAK-së, propozojmë Bahri Gashin.

Gëzim Mehmeti tha se ne si GP që jemi nuk mundet askush me na apostrofuat çështjen e kandidimit, nuk ka të drejtë ligjore që një grupi parlamentar t'i mohohet e drejta e kandidimit.

Endrit Zabërgja tha se duke e pasur vullnetin dhe dëshirën që të jem sa më afër qytetarëve dhe t'i përçojë kërkesat dhe hallet e tyre, dhe duke e ditur që si parti politike jemi të ndarë nga të tjerat, e konsideroj edhe unë të nevojshme edhe të domosdoshme që në raste të tilla, ne të cilët nuk kemi ndoshta shumë hapësirë në institucione, të na jepet përparësi, në këtë rast si anëtarë i Kuvendit komunal unë e përfaqësoj vetveten të jem në këtë grup.

Gëzim Sveçla shprehu mendimin se për këtë çështje ka nevojë të bëhet interpretim i rregullores, edhe të sqarohet formula se qysh bëhet zgjedhja e anëtarëve të komisionit. Lidhur me këtë shtoi se, ne si GP nuk kemi asgjë kundër AKR-së e as kundër NISMA-së, as kundër askujt, mirëpo nuk është logjika e njëjtë tash nëse një grup i cili i ka 17 asamblistë, me u përfaqësua njësoj si një grup që i ka një ose dy asamblistë. Në këtë rast ose duhet ne t'i propozojmë dy përfaqësues për këtë grup, ose kërkojmë interpretim ligjor në MAPL.

Feim Osmani tha se edhe Rregullorja e vitit 2010, e cila ka qenë në fuqi, e ka paraparë me qenë pesë anëtarë nga Kuvendi dhe as atëherë nuk kanë mundur me u përfaqësuar të gjitha subjektet, megjithatë sipas formulës që ka qenë para kësaj të fundit, do të ishte në favor të VV-së të kthehet ajo që ishte më përpara, mirëpo rregullorja është votuar, tashmë jemi para një akti që kemi marrë vendim.

Hafiz Krasniqi tha se unë shpreh mendimin që kjo çështje të procedohet sipas rregullores, e cila veç e parasheh që grupet parlamentare të cilat kanë përfaqësimin më të lartë, pra janë katër të parat, kështu që të shkojë në bazë të rregullores.

Leutrim Retkoceri u shpreh se përfaqësimi në këtë rast në këtë komision do të jetë në bazë të numrit të votave që i kanë marrë në zgjedhjet lokale, pra kush e mbërrin përqindjen më të lartë përfaqësohen në komision. Sa i përket çështjes së barazisë gjinore, mendojë që nga të dyja subjektet nga koalicioni janë propozuar një grua dhe një burrë, ndërsa sa i përket propozimit që duhet të vijë nga opozita, njëri duhet jetë grua dhe tjetri burrë.

Lidhur me vërejtët dhe sugjerimet e dhëna nga parafolësit, sqarime shtesë dha Bersant Beka, drejtor.

Me propozimet e dhëna, kryesuesi konstatoi se më 15 vota për, nuk është miratuar Propozimvendimi për caktimin e komisionit për udhëheqjen dhe koordinimin e punës në terren për përzgjedhjen e këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane.

Pika e gjashtë

Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve financiare për NPL "Kuzhina Qendrore".

Lindita Rexhepi tha se kjo ndërmarrje ka kërkuar një subvencionim në vlerë prej 35 mijë euro, për të investuar në instalimin e paneleve solare në kulmin e ndërmarrjes, i cili sipas ekspertëve të fushës ofron një kënd të rënies së rrezeve të diellit 90grad celsius. Ne si Grup i asamblistëve e kemi analizuar këtë kërkesë të ndërmarrjes dhe jemi në përkrahje të këtij propozimvendimi. **Agim Kuleta** tha se i përgëzojë drejtuesit e ndërmarrjes për këtë iniciativë dhe për punën që janë duke e bërë, por më tepër i inkurajoj të gjitha institucionet e tjera, të gjitha ndërmarrjet tjera, që në bashkëpunim edhe me Komunën, me mundësitë financiare ta fillojmë këtë procedurë të shfrytëzimit të formave alternative për furnizim me rrymë.

Kryesuesi konstatoi se më 38 vota për dhe 1 kundër, u miratua Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për NPL "Kuzhina Qendrore".

Pika e shtatë

Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve financiare për NPL "Hortikultura".

Leutrim Retkoceri tha se pas një analize që i është bërë raporteve financiare të kësaj ndërmarrjeje, është vërejtur se është jashtëzakonisht e nevojshme një ndihmë financiare që do ta kategorizonte ndërmarrjen në një ndërmarrje rentabile, e cila gradualisht do të organizohet që në të ardhmen të ketë edhe të hyra të saj vetanake, duke pasur parasysh që shumica e mjeteve të kësaj ndërmarrje janë dedikuar nga kontrata që e ka me Komunën e Prishtinës.

Në kuadër të saj, është e nevojshme që kësaj ndërmarrje, e cila po ballafaqohet me sfida dhe vështirësi të natyrave të ndryshme, duke filluar me mungesë të kapaciteteve financiare, për të bërë investime kapitale në ndërmarrje, mungesë të makinerive të ndryshme, duke shtuar edhe faktin se një pjesë e tyre është jashtë funksionit për shkak të defekteve, mungesave të tjera të mjeteve adekuate për të zgjeruar hapësirat e gjelbra, është po e nevojshme që ky subvencion të ndodh dhe të propozohet në Kuvendin komunal.

Duke u bazuar në këto argumente, kërkoj që kjo pikë të mbështetet nga të gjithë anëtarët e Kuvendit.

Gëzim Sveçla tha se në rastin e tanishëm kemi të bëjmë me një subvencion, por ku nuk ka një përcaktim të qartë se ku do të shkojnë këto mjete. Lista e nevojave apo kërkesave emergjente e cila na është dorëzuar, besoj që shuma për të cilën po flasim për ta ndarë nuk e mbulon as 1/10 e këtyre pjesëve të cilat janë të nevojshme të blihen nga ndërmarrja "Hortikultura". Megjithatë, është pak e çuditshme kjo mënyra se si po ndajmë subvencione e nuk po kemi raportime për ndërmarrjet, prandaj duhet të jetë një transparencë më e madhe.

Për hir të asaj që t'i jepet edhe një rast ndërmarrjes "Hortikultura" dhe në mënyrë që të mos bëhemi pengesë që eventualisht të stopojmë proceset që kanë të bëjnë me forcimin dhe

stabilizimin ekonomik të ndërmarrjes, ne kësaj radhe do ta përkrahim këtë subvencion, mirëpo ju bëjme dije se do të jetë hera e fundit që përkrahim subvencione që nuk marrim çoftë raporte financiare, çoftë raporte për gjendjen, çoftë studime të fizibilitetit për mjetet të cilat parashihet të blihen për nevojat e ndërmarrjes.

Valbona Ajeti tha se edhe ne si GP e përkrahim edhe subvencionin e ndërmarrjes "Hortikultura", duke e marrë parasysh se këto kërkesa që janë listuar janë më se të nevojshme.

Sami Boroci tha se në parim jam kundër subvencionimeve të ndërmarrjeve publike në formë klasike, po besoj që kjo nuk është një formë e tillë. Mendoj që ndërmarrjet publike duhet me qenë të qëndrueshme në aspektin financiar, por në këtë rast mundemi me e mbështetur derisa e ka një arsyeshmëri për një investim të caktuar, mirëpo në të ardhmen, mendoj se duhet me qenë shumë më të arsyeshme dhe më logjike pse ne duhet ta subvencionojmë atë ndërmarrje.

Endrit Zabërgja u shpreh se edhe ne e mbështesim këtë subvencionim, duke e pasur parasysh se listimi këtu tregon për një gjendje të jashtëzakonshme dhe nevojën për mjete elementare të punës. Mendoj se është e domosdoshme që para subvencionimeve të tjera të kemi raport nga secila ndërmarrje, raport të detajuar, pasi që pas kësaj seance as unë nuk do të votoj pa e pasur së paku raportin e aksionarëve.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 39 vota për, u miratua Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për NPL "Hortikultura".

Pika e tetë

Informatë lidhur me Raportin vjetor të komisionit të aksionarëve të NPL "Pallati i Rinisë".

Fiknete Bejta, në cilësinë e anëtares së Komisionit komunal të aksionarëve, tha se si komision kemi kërkuar që të informojmë Kuvendin komunal të Prishtinës me punën e ndërmarrjes publike lokale "Pallati i Rinisë", që nga nga 27 prill i vitit 2022 e deri më sot. Nga data e cekur dhe deri më sot, ne kemi ushtruar dhe kemi mbikëqyrë në mënyrë të vazhdueshme dhe rigorozve veprimtarinë e Bordit të drejtorëve dhe Komisionit të auditimit të ndërmarrjes publike lokale.

Meqenëse ndërmarrja nuk ka pasur bord, më 19 qershor kemi emëruar bordin e ndërmarrjes, duke u bazuar në Ligjin për ndërmarrjet publike lokale dhe kompetencat që derivojnë për Komisionin e aksionarëve. Bordi i ri që është emëruar nga ne, është në pajtim të plotë, duke respektuar ligjin dhe kriterin profesional. Gjatë analizës së gjendjes në ndërmarrje, kemi konstatuar se ndërmarrja në fjalë kishte mangësi të theksuara në rregullativën e brendshme dhe në organizim. Brenda kësaj kohe, kemi hartuar sipas procedurave të parapara me ligj dhe duke respektuar të gjitha ligjet në fuqi, rregullore që janë shumë të nevojshme për funksionimin e ndërmarrjes, si Rregulloren e punës së komiteteve të bordit të drejtorëve, Rregulloren e marrëdhënies së punës dhe procedurës disiplinore në Pallatin e Rinisë, Rregulloren për orarin e punës, Rregulloren për arka, Rregulloren mbi pagat dhe mbi kompensimet e tjera të ndërmarrjes publike lokale "Pallati i Rinisë", Organogramin e ri, Rregulloren e brendshme të rendit shtëpiak të Qendrës tregtare, si dhe Rregulloren mbi organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e pozitive dhe përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi të punës.

Bordi i kësaj ndërmarrje përmes ushtruesit të detyrës së kryeshefit ekzekutiv, ka zhvilluar aktivitete përmes të cilave është zhvilluar dhe ka avancuar aspekti administrativ dhe operativ i ndërmarrjes.

Si komision komunal i aksionarëve, brenda kësaj periudhe kohore ka mbajtur më se 11 takime efektive pune, shumica e tyre së bashku me bordin. Janë larguar të gjitha reklamat dhe billbordet para dyqaneve, brenda dhe jashtë hapësirës së pallatit, janë larguar shumë pengesa për shfrytëzimin e hapësirave, duke përfshirë pjesët e ndërtuara dhe muret e reja të ndërtuara ilegalisht dhe në kundërshtim me ligjet në fuqi.

Po ashtu, ekipi i Pallatit të Rinisë ka qenë i angazhuar në mënyrë aktive në organizimin e Manifetës, sa i përket pjesës së organizuar në hapësirat e Pallatit të Rinisë. Është bërë ngjyrosja e hapësirave të bardha, duke përfshi këtu edhe pjesën ikonike të objektit, ndërtimi i vendkalimit për persona me aftësi të kufizuara, restaurimi dhe aktivizimi i fontanës së re.

Kemi zhvilluar takime pune me qëllim të sigurimit të fondeve për investimet në pallat me disa nga ambasadat në vend, si me Bankën Botërore dhe BERZH-in.

Gjatë kësaj kohe kemi bërë edhe një plan të investimeve, përmes buxhetit të Drejtorisë së Sportit, ku janë zotuar 50 mijë euro investim, në rregullimin e ndriçimit në sallën e basketit dhe rregullimin e zërimit. Mendohet të sanohen edhe disa probleme të tjera, si në instalimin e rrymës, rregullimin e ventilimit, si dhe sanimin e kulmit të objektit.

Kërkoj nga Kuvendi komunal që ta hartojë një propozimvendim për bartjen edhe formalisht të pronës së Pallatit të Rinisë, duke përfshirë edhe pronat e ish-ndërmarrjes "Komunalia", e cila sipas ligjit është inekzistent, por një pjese e pronës së Pallatit të Rinisë figuron në pronësinë e saj dhe gjithësesi këto prona të barten në pronësi të ndërmarrjes publike lokale "Pallati i Rinisë".

U konstatua se u përkrah Informata lidhur me Raportin vjetor të Komisionit të aksionarëve të NPL "Pallati i Rinisë".

Pika e nëntë

Informatë lidhur me Raportin vjetor të Komisionit të aksionarëve të NPL "Hortikultura".

Kumrije Shabani - Ramadani, në cilësinë e anëtares së Komisionit komunal të aksionarëve, tha se pas marrjes së detyrës së bordit të përkohshëm, është bërë vlerësimi i gjendjes aktuale të qëndrueshmëria e ndërmarrjes, duke bërë edhe shikimin dhe veprimin e vendimeve të bordit të kaluar, përfshirë edhe veprimet e zyrtarëve të lartë të ndërmarrjes. Nga këto veprime ka pasur të gjetura të cilat kanë konsideruar pa mbështetje ligjore e disa edhe jo të favorshme për ndërmarrjen në aspektin organizativ dhe financiar. Duke i parë këto veprime nga ana e bordit, fillimisht është bërë shfuqizimi i vendimit të bordit të kaluar, që i ishte vazhduar mandati kryeshefit ekzekutiv pa iu nënshtruar procedurave të konkursit, siç përcaktohet me ligj, dhe njëherësh duke caktuar ushtrues detyre të kryeshefit ekzekutiv, që të mos krijohet një vakum institucional në udhëheqjen e ndërmarrjes. Tutje është bërë vlerësimi i ndërmarrjes në të gjitha sferat organizative, duke filluar nga organizimi brenda administratës, kushtet e punëtoreve të administratës, njësitë e terrenit, makineria si aset i ndërmarrjes, funksionimi i serrave dhe kultivimi i luleve etj.

Kjo ndërmarrje ka mungesa të mjeteve të nevojshme për punë, siç janë kompjuterët, tavolinat e punës, karrige pune, duke përfshirë edhe gjërat me elementare, mungesa e e-mailit zyrtar të ndërmarrjes në një sistem të inkorporuar, mungesë të ueb-faqes së ndërmarrjes, si dhe mungesa e uniformave dhe mjeteve të nevojshme për punë ditore dhe për punë fizike.

Aktet ligjore të brendshme të ndërmarrjes, të cilat e rregullojnë organizimin e brendshëm, një pjesë e tyre mungojnë, mandej edhe përmbajtja e hierarkisë raportuese të dyfishtë, shuarje të pozitive, trajtimi jo i barabartë brenda ndërmarrjes dhe njësive të ndryshme. Po ashtu, ndërmarrja ka një bashkëpunim të ngushtë me Drejtorinë e Shërbimeve Publike. Gjithashtu edhe për veprime të tjera të ndërmarrja, një falënderim i veçantë është për të gjithë punonjësit të cilët kanë qenë jashtëzakonisht të angazhuar në punë për mbjelljen e drurëve, shkurreve dekorues, dhe krasitjen e pemëve, e cila po bëhet sipas kërkesës në bashkëpunim me Drejtorinë e Parqeve.

Arbnora Ajeti, në cilësinë e anëtares së Komisionit komunal të aksionarëve në këtë ndërmarrje, tha se ndërmarrja komunale "Hortikultura" ka arkëtuar gjithsej 1 milion e 37 mijë e 310 euro të hyra vetanake në perudhën janar-shtator 2022, ku shumica e të hyrave janë nga kontrata me Komunën e Prishtinës, në vlerë prej 954 mijë e 175 euro, kurse pjesa tjetër janë nga shërbimet tjera.

Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe kemi arritur marrëveshje të reja, si me Ujësjiellësin e Prishtinës, kontrata me ndërmarrjen "Pastrimi", kontrata me Policinë e Kosovës, me KMDK-në dhe kontrata me Sunny Hill. Në këtë raport po ashtu janë pasqyruar objektivat e përgjithshme të planifikuara sa i përket mirëmbajtjes së hapësirave gjelbëruese në masë të madhe. Pavarësisht sfidave të paraqitura në këtë periudhë, "Hortikultura" ka mobilizuar në tërësi punëtorët e ndërmarrjes për ruajtjen e florës dhe faunës në peizazhin e mbrojtur të Gërmisë nga zjarret dhe nga dëmtimet, mbjelljen e luleve sezonale dhe shumëvjeçare, si dhe ka formuar komisione për riparimin e mekanizmit të ardhur nga Komuna e Prishtinës nga vitet e kaluara.

U konstatua se u përkrah Informata lidhur me Raportin vjetor të komisionit të aksionarëve të NPL "Hortikultura".

**Pika e dhjetë
Pyetje dhe përgjigje.**

Sami Boroci, për nënkryetarin e Komunës:

- Jemi në dijeni se NPL "Sport Marketing" do ta ketë në menaxhim stadiumin e Prishtinës, prandaj kërkoj të dijë se a ka një plan konkret për këtë pjesë dhe pajtohem që duhet me e organizuar si ndërmarrje dhe me pasur ndërmarrje profitabile. Po ashtu, a ka ndonjë plan se si të menaxhohen edhe hapësirat reklamuese në Prishtinë.

Gëzim Sveçla, për drejtorin e Drejtorisë së Inspektionit, për nënkryetarin e Komunës, për kryetarin e Komunës dhe për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

- Ankesa e banorëve nga "Prishtina Star's", në Aktash, ndërtesa e Konakut në rrugën "Llordi Bajron", ka të bëjë me disa punime pa leje në kulmin e rrafshët të ndërtesës dhe 25 familje të tjera kanë probleme me ajër, kanë mungesë të ajrit, për shkak se oxhaqet që kanë qenë funksionale i është ndërruar forma dhe tash si të tilla janë jashtë funksionit. Drejtoria e Urbanizmit ka marrë vendim për kthimin e gjendjes fillestare siç ka qenë, mirëpo nuk është vepruar në këtë drejtim.
- Pse nuk po zbatohet ai vendim?
- Telat e operatorëve të ndryshëm të telekomunikacionit, tela të rrymës në lagjen "Pejton", konkretisht rrugën "Pashko Vasa", paraqesin shumë problem, rrezik për njerëzit dhe pronën, ndërkohë që ekzistojnë kabllot nëntokësore dhe nuk di arsyen pse nuk po funksionojnë ato.
- Një shqetësim tjetër i cili është ngritur nga qytetarët, ka të bëjë me tabelat e ndërmarrjes komunale "Prishtina Parking" nëpër lagje, nëpër të cilat kjo kompani nuk operon, kështu që shumë qytetarë bien pre e këtyre tabelave dhe dërgojnë SMS, tarifohen, në ndërkohë që kurrfarë shërbimi nuk kanë në ato lagje.
- Po ashtu, kemi marr shumë ankesa për rrugët e dëmtuara dhe dëmi që iu shkaktohet veturave nga këto rrugë, ka nevojë për një adresë të saktë se ku mund të orientohen qytetarët për të kërkuar kompensimin e nevojshëm, pasi siç dihet se paguhet një taksë rrugore dhe në bazë të asaj takse rrugët do duhej të ishin në një gjendje më të mirë sesa që janë tani.
- Pse po ndodh lirimi i hapësirave në mënyrë selektive, jo njësoj për të gjithë?
- Në cilën fazë jemi me hartat zonale, kur do të jetë gati plani për lagjen "Kalabria" dhe çfarë po ndodhë me Rregulloren e "Prishtina Parking", e cila është një prej rregulloreve të para që e kemi përmendur e akoma nuk na ka ardhur këtu?
- Në malet e Gërmisë të cilat janë me shumë drurë të shkukur, të cilët vazhdimisht gjenden në këtë sezon, është mirë që kjo të shfrytëzohet në këtë fazë kur ka probleme me energji elektrike dhe ata drurë të mblidhen dhe të ndahen për familjet në nevojë që janë në Komunën e Prishtinës.
- Banorët e lagjes "Mati" kërkojnë mirëmbajtjen e varrezave, andaj do të ishte mirë që t'iu kushtohet rëndësi me aq sa ka mundësi këtyre varrezave.

Triera Kasumi - Berisha, për kryetarin e Komunës, për drejtorin e Drejtorisë së Inspeksionit, për drejtoreshën e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale dhe për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike:

- Kërkoj nga të gjithë drejtorët e drejtorive të Komunës që të përgjigjen pozitivisht ose edhe t'i shtyjnë ftesat të cilat i drejtohen prej Komitetit për komunitete, për shkak se në të gjitha mbledhjet që kam qenë prezent nuk e kemi pasur kurrë të pranishëm asnjë drejtor. Në mbledhjen e fundit pos tjerash, është diskutuar edhe për familjet që janë në asistencë sociale, kështu që kërkoj nga Kuvendi dhe drejtoritë përkatëse, me e ngritë si çështje dhe me e trajtuar pak më seriozisht, pasi që kemi të bëjmë me një kategori shumë të ndjeshme të banorëve të komunës së Prishtinës, përfshirë këtu

- edhe një iniciativë për disa drurë të cilët janë mbledhur prej Drejtorisë së Inspeksionit, me gjetur mekanizma që këto dru të shfrytëzohen nga këto familje.
- Në rrugën "Ahmet Korenica" janë tri parcela që sipas banorëve, parcela është e planifikuar për rrugë, ndërsa në këto parcela është hapur një gropë relativisht e madhe, mbi të cilën nuk ka asnjë tabelë informuese që tregon se ekziston një leje ndërtimi ose një plan specifik. Si pasojë e kësaj ngrihet edhe çështja e sigurisë, meqë kjo gropë e madhe e cila tash është edhe e mbushur me ujë, është vetëm 1m larg parkingut dhe nuk ka ndonjë kufizim ose perimetër mbrojtës.
 - Kur do ta kemi Rregulloren për "Prishtina Parking", kur e dimë se kemi çaluar shumë në menaxhimin e mirëfilltë të kësaj ndërmarrje në shumë procese?
 - I propozoj Kuvendit të Komunës së Prishtinës ta krijojë një komision, i cili e mbron Softwerin e "Prishtina Parking" nga vetë mbrojtësit dhe anëtarët e kësaj ndërmarrje.
 - Propozoj të hiqen rrethojat e Parkut të qytetit, pasi që kemi vlerësuar se pavarësisht që 30% e rrethojave të parkut bien direkt në oborret e shtëpive private. Kemi varreza të cilat kanë dal mbetje mortore në pah në Parkun e qytetit dhe përkundër lajmërimit, nuk është ndërmarrë ende asnjë masë për këtë çështje.

Rashit Gashi, për kryetarin e Komunës dhe drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave:

- A është ndërmarrë ndonjë hap në shtrirjen e rrjetit të ujësjellësit për në fshatrat e Gollakut, konkretisht për fshatin Mramor, kërkesë të cilën e kam ngritura në seancën e muajit mars dhe nuk e dimë ku ka ngelur ky proces. Kishim dashur një përgjigje konkrete se kur do të fillojë, sepse ky proces po zvarritet diku prej vitit 2014, nga viti në vit barten mjetet dhe asnjëherë ky proces nuk ka filluar.
- Janë disa rrugica në fshatin Mramor, si ajo "Muharrem Ramizi" dhe "Halit Gashi", edhe përkundër kërkesës së mëhershme, deri më tani ende nuk është zhvilluar asnjë procedurë për ndërtimin e tyre.
- Një kërkesë e punëtorëve të ndërmarrjes publike lokale "Trafiku Urban", se procedurat të cilat po zhvillohen me konkurse të jashtme, ankohen se nuk po iu jepen mundësi sa duhet në konkurse interne. Tash ka pasur një konkurs për shoferë dhe konduktorë, ku mbi 40 shoferë të cilët punojnë për momentin janë konduktorë, por kanë kategorinë "D", janë vozitës të cilët e njohin rrugën, e njohin çdo stacion në komunën e Prishtinës dhe me një investim ose pa investim fare, me një rekrutim krejt të vogël ata mund të transferohen në pozita për shoferë kurse iu ka dhënë mundësia në konkurse të jashtme të pranohen shofer të ri.

Mirsad Vitia, për kryetarin e Komunës:

- Vendimin që e ka marrë Kuvendi i Komunës, më 17.03.2022, për lirim nga pagesat e transportit publik NPL "Trafiku Urban" për zjarrfikësit, Policinë e Kosovës dhe nxënësit e shkollave fillore të komunës së Prishtinës dhe po atë ditë kemi marr premtimin nga z. Zogaj, nënkryetar i Komunës së Prishtinës, që do të ulet dhe do të dakordohet me operatorët privatë ekonomikë për transportin e udhëtarëve për lagjet

ku nuk operon "Trafiku Urban", në mënyrë që të përfshihen edhe të tjerët që vijnë nga lagjet apo fshatrat e komunës sonë. Nuk e di çka është bërë në atë drejtim dhe më intereson ta kem si informacion.

- Në mandatin e kaluar është marrë një vendim që ka të bëjë me laptopët që u janë dhënë anëtarëve të Kuvendit të Komunës dhe ata laptopë kur janë dhënë është thënë se duhet të kthehen me përfundim të mandatit të anëtarit të Kuvendit dhe nuk e di nëse dikush i ka kthyer. Besoj se ata janë pasuri e Komunës dhe duhet të kthehen.

Gresa Lahu, për drejtorin e Drejtorisë së Shëndetësisë:

- Ndonëse jemi të vetëdijshëm për dinamikën e rasteve me sëmundjen e kancerit të gjirit, sëmundje kjo që atakon gratë kryesisht, në numër më të madh, shqetësues është sot fakti si këtu sot në këtë sallë, me idenë e kujtdo, pranë nesh kemi nga një bluzë, ku në mbishkrim është vendosur "Prishtina po bëhet rozë", në ndërkohë fatkeqësisht gjatë këtyre ditëve me radhë kam marrë thirrje të shumta nga qytetarët e komunës dhe më gjerë për listën e gjatë të pritjes për mamografi, kështu që saktësisht përbrenda këtij muaji kanë arritur terminet deri në fillimin e vitit 2023. Duke e ditur që sa i përket një kontrole kualitative të programit për zbulimin e mundshëm të kancerit të gjirit, metoda e mamografisë është aktualisht metoda më e rekomanduar për të hetuar me kohë këtë sëmundje. Uroj që ky muaj të mos jetë vetëm muaji i reklamave kundër kancerit të gjirit, mirëpo në kuptimin e plotë të fjalës, të shtohen kapacitetet fuqishëm në preventivë diagnostikimi e shërim përgjatë gjithë viti.

Besart Krasniqi, për kryetarin e Komunës dhe për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike:

- Për të pasur perspektivë fshatrat e Gollakut, mendoj që duhet të ketë një linjë të rregullt të autobusëve, gjë që iu mungon atyre fshatrave. Fshati Siçievë, Sharban, Marevc kanë mungesë të autobusëve, po ashtu fshatrat e tjera që kanë autobusë nuk kanë linja të rregullta të autobusëve, nuk kanë linja të shpeshta dhe orare më të gjata që po kërkojnë. I njëjti shqetësim është edhe me disa lagje brenda kryeqytetit, si ish-rruga "Bledi", lagja "Velania", lagja "Medrese" konkretisht pjesa prej Sheshit të Arbit deri tek rruga "Tomori". Po ashtu, është kërkesë e qytetarëve që edhe operatorët privatë të kenë orar më të gjatë dhe linja të rregullta të autobusëve.

Feim Osmani, për kryetarin e Komunës dhe për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike:

- Banorët e fshatit Tenezhdoll të cilët udhëtojnë për Prishtinë me linjat e transportit të udhëtarëve, kanë paraqitur shqetësimin e tyre lidhur me linjat dhe oraret e transportit të udhëtarëve. Këtë shqetësim të tyre e kam parashtruar edhe më parë, e që deri më tani nuk është marrë asnjë hap për përmirësimin e gjendjes. Shqetësimi kryesor është se në orën 07:00 të mëngjesit nxënësit të cilët e fillojnë procesin e mësimin në ora 08:00, ata duhet diku 15 minuta para orës 07:00 të jenë në stacion të

autobusëve për të arritur në Prishtinë me kohë, sepse nga ora 07:00 e tutje më asnjë autobus që qarkullon nga Podujeva nuk ka vend dhe as nuk ndalen në stacione. Do të ishte mirë që të bëhet një organizim më i mirë për lehtësimin e vijimit të nxënësve nëpër shkollat e Prishtinës, si dhe të qytetarëve tjerë të cilët duhet patjetër të shkojnë në këto orare në punë.

- Çështje tjetër është se transporti për nxënësit e fshatit Trudë kanë mbetur në një zonë të ashtuquajtur qorre, mirëpo për të vazhduar mësimin në Bardhosh duhet të kalojnë nëpër magjistrale 2 km rrugë, dhe kanë bërë kërkesë disa herë që tu mundësohet transporti. Ai kufizimi i ligjit që duhet të jetë 4 km ose nuk duhet të merret parasysh në këtë rast, duhet të bëhet përjashtim, për shkak të rrezikshmërisë të cilën ata e kalojnë në rrugë.
- Kur do të bëhet pastrimi i lumit Llap, që është më se i domosdoshëm? Koha ideale do të ishte tani.

Amir Simnica, për drejtorin e Drejtorisë së Inspeksionit dhe për kryetarin e Komunës:

- Banorët e konakut "Prishtina Stars", në rrugën "Lord Bajron", faktikisht kanë pasur ankesë lidhur me bllokimin e tubave të ajrosjes, dhe duke pasur parasysh se në atë objekt është një person që ka telashe me alergji, d.m.th. atij i rëndohet shumë gjendja në raport me të tjerët, sepse nuk ka ajrosje të mjaftueshme në banesë.

Violeta Salihu, për kryetarin e Komunës:

- Çka ka ndodhur me kontratën prej 700 mijë euro të "Prishtina Parking", të cilën e kishim denoncuar në më herët si Grup, e më pas këtë e kishte bërë edhe nënkryetarja Donjeta Sahatçiu, a e keni anuluar dhe a e keni denoncuar në organet kompetente?
- Kërkoj nga kryetari i Komunës që së bashku me drejtoritë përkatëse, ta bëjnë një zgjidhje të qëndrueshme për qasjen e personave me aftësi të kufizuara në objektin e Komunës, pasi që ashensori në shumicën e rasteve është jashtë funksionit.

Leutrim Retkoceri, për drejtorin e Drejtorisë së Administratës dhe për kryetarin e Komunës:

- Mendoj se është koha që të gjithë asamblistët të pajisen me kartelat e tyre, është mirë për shkak se duhet të identifikohen të gjithë asamblistët me kartat e tyre. Kjo ka qenë në mandatin e kaluar dhe shpresoj të bëhet edhe në këtë mandat.
- Kërkoj të bëhet një zgjidhje që materialet për mbledhje të përgatiten dhe të na sillen në Kuvend. E di që për shkak të shtypit dhe për shkak të të gjelbrës dhe riciklimit janë hequr materialet, mirëpo ka mungesë të laptopëve të cilët asamblistët do të mund t'i lexonin pikat e rendit të ditës, për shkak se e vërej gjatë diskutimeve ndonjëherë ka edhe mungesë të qasjeve të dokumenteve që i servohen asamblistëve qoftë edhe pikat e rendit të ditës, të cilat mund të futen gjatë seancës apo vijnë me vonës.

- Kërkoj që në hapësirat e objektit të Komunës të jetë një zyre për anëtarët e Kuvendit, për shkak të transparencës së takimeve, pyetjeve dhe shqetësimeve që i kanë qytetarët, ku një pjesë të madhe mund t'i bëjnë edhe asamblistët brenda objektit të Komunës duke i pritur qytetarët në takime.

Lindita Rexhepi, për drejtoreshën e Drejtorisë së Parqeve dhe për drejtorin e Drejtorisë së Sportit:

- Qytetarët e lagjes "Ulpiana" kërkojnë urgjentisht që të intervenohet në parkun e Ulpianës, që ky park e ka një gjendje jo të mirë pikërisht në këndin e lojërave. Lojërat janë jashtë funksionimit, apo më mirë të themi janë në rrezik, ku fëmijët tanë dalin çdo ditë dhe lidhet drejtpërdrejt me sigurinë e tyre. Kërkoj nga këto dy drejtori që në mundësinë e parë të mundshme të intervenojnë në këtë pjesë.

Agim Kuleta, për kryetarin e Komunës:

- Mbledhja e drurëve prej Gërmisë dhe vendeve të ndryshme që ato me ua ndarë familjeve që janë raste sociale, mendoj që sivjet duhet që kjo të merret shumë më seriozisht dhe të jetë një lloj fushate që të pastrohet komplet Gërmia, në mënyrë që të ketë një sasi më të madhe të drurëve, duke marrë parasysh situatën e rënd që e kemi me energjinë elektrike, por edhe në përgjithësi ekonomike dhe sociale.
- Çështja për ndryshimin e rendit të ditës, që pikat "Pyetje dhe përgjigje" të jenë pika të para në rend dite, këtë çështje e kemi ngritur edhe në mandatin e kaluar, por mendoj se kjo çështje nuk është funksionale, për arsye se nuk ka rregulla pastaj dhe mund të zgjatë shumë deri sa të fillojë diskutimi për pikat e tjera të rendit të ditës. Mendoj që nëse kjo çështje rregullohet me rregullore dhe të parashihet edhe koha e caktuar, dhe në njëfarë mënyre të merret modeli që ekziston në Kuvendin e Kosovës, që të përgatiten pyetjet më herët, t'u dërgohen drejtorëve, në mënyrë që edhe ata të kenë përgjigje kompetente për ato çështje e jo të japin përgjigje ad-hock për ato çështje. Kështu që unë tash po e shfrytëzoj rastin që, nëse janë të interesuar shefat e grupeve parlamentare, mund ta organizojmë një takim dhe unë vij me draft që kemi punuar atëherë, por edhe e kam përpunuar në ndërkohë, dhe mund të diskutojmë, t'i futemi iniciativës për ta ndryshuar Rregulloren e Kuvendit komunal.

Lidhur me pyetjet dhe kërkesat e parashtruara nga parafolësit, përgjigje dhanë: Bersant Beka, drejtor, Përparim Rama, kryetar dhe Mimoza Sylejmani, drejtoreshë.

Pika e njëmbëdhjetë Të ndryshme

Triera Kasumi - Berisha tha se largimi i rrethojave nga Parku i qytetit, mendoj se nuk qëndron, pasi që ato rrethoja e mbrojnë parkun. Ne e dimë që shumica e qytetarëve të Prishtinës mund të vijnë ta bëjnë një vizitë të shkurtër, por për komunitetin i cili jeton aty, sidomos për fëmijët, parashihet një rrezik shumë i lartë, për atë dhe kam ngritur si çështje. Çfarë mekanizma të tjerë do të ndërmerren nëse ne i heqim ato rrethoja, jo pse parku ka pasur një orar të funksionimit dhe me ato rrethoja që kanë qenë nuk është lejuar hyrja, por po besoj që duhet ta mendojmë edhe këtë anën tjetër sociale. Kërkoj që nëse është e

mundur që atë pjesë të këndeve të lojërave për fëmijët e vegjël me e rrethuar, që bile ata me qenë të sigurt dhe të mos ekspozohen tek rruga, meqë ka edhe pjerrtësi.

Po ashtu, ka qenë e planifikuar që të bëhet një rregullore për parqet, ku është cekur se kjo vjen edhe si rezultat për pjesën e gastronomeve, të cilët do të lejohen të funksionojnë në këto parqe. Kur do ta kemi këtë rregullore?

Sa ka kompetencë Komuna e Prishtinës për largimin e reklamave prej hotelit "Grand", përderisa e dimë që ky është aset në likuidim në AKP, cilët janë mekanizmat që do t'i ngrini, sepse është shumë e nevojshme?

Gjithashtu kërkoj që të jetë një rregullore, ku specifikohet drita e ekraneve të mëdha. Ne e dimë që aty afër hotelit "Grand" e kemi një ekran gjigand, i cili përveç që harxhon shumë energji elektrike, rrezikon shumë komunikacionin, sepse është përball vozitësve dhe e vështirëson shikimin e rrugës.

Sa i përket aplikacionit të "Prishtina Parking", aplikacioni po inkason, i vjetri po inkason dhe ju kisha lutur të na bëni një shpjegim për projektin e tunelit të Dardania. Në projektin e ri ju parashihni që aty të ketë kafene, qëndrim, rekreacion, si parashihet kjo të bëhet kur e dimë se aty lirohet në masë monoksidi i karbonit nga gazrat e veturave?

Gëzim Sveçla tha se në pamundësi që të futet në rend të ditës çështja e Ndërmarrjes Publike Banesore, e shoh më se të domosdoshme që edhe njëherë të flas mbi Ndërmarrjen Publike Banesore dhe projektin në "Lakërishtë", ku bëhet fjalë për 17 mijë m² të cilat janë duke u grabitur. Kryetar, siç e dini policia ka kryer bastisje në zyrat e kësaj ndërmarrje gjatë mandatit tuaj dhe ju keni heshtur, e bashkë me ju edhe aksionarët, a mund të na tregoni çfarë veprime keni marr për këtë çështje? Ju e keni vendosur edhe auditorin në këtë ndërmarrje, a keni kërkuar dhe a është kryer auditim për këtë kontratë që është objekt i diskutimit. Ju thatë se personalisht jeni për ta shndërruar në park atë hapësirë, në ndërkohë që aksionarët e Komunës po e mbrojnë këtë kontratë, e cila nuk parasheh park por parasheh ndërtime të larta, dhe mbi të gjitha parasheh tjetërsim të pronës publike. Dëshët apo nuk deshët, kjo çështja e 17 mijë m² në qendër të Prishtinës do të ju përcjellë gjatë gjithë mandatit edhe pas mandatit, prandaj mendojmë dhe vlerësojmë se është koha e fundit të merrni përgjegjësi, të merrni veprime. Heshtja në njëfarë mënyre është miratim, e për më tepër është miratim i orkestruar.

Rashit Gashi tha se me liqenin e Badovcit që furnizohet nga rrjedhjet e përroskave nga zona e Gollakut, furnizohen rreth 40% e qytetarëve të Prishtinës. Ajo dilema apo frika e ujësjellësit KRU "Prishtina" se mund të keqpërdoret uji, mund të them nuk qëndron. Atyre duhet bërë me dije se ata ujë është pikërisht nga ajo zonë, 40% e atyre pronave ku shtrihet sot liqeni i Badovcit janë zona në malësinë e Gollakut, që ua kanë marr dikur në fund të viteve të 60-ta, prandaj këtë duhet me e pasur parasysh.

Violeta Salihu paraqiti disa shqetësime prej hendbollisteve të klubit "Prishtina", lidhur me subvencionimin e klubeve nga ana e Komunës, andaj kërkoj të dijë se kur i subvenciononi ato klube, a merrni informata çka kanë bërë ata paraprakisht, apo a kërkonin plan të detajuar, sepse klubi nuk i paguan hendbollistët, d.m.th. edhe pse kanë kontratë të nënshkruar.

Për çka atëherë i subvencionon Komuna nëse keqtrajtohen vajzat e reja, kur ne d.m.th. nonstop po aludojmë në atë që duhet të integrohen vajzat në sport, mirëpo nëse

keqtrajtohen me subvencionet tona, atëherë kjo është shumë e pakuptimtë. Duhet ta bëjmë një rregullore që të kërkojmë plan të detajuar për ato subvencione.

Lidhur me shqetësimin e ngritur nga znj. Salihu, sqarime të nevojshme dha Donjeta Sahatçiu, nënkryetare.

Agim Kuleta, lidhur me çështjen e llaptopëve, tha se shfrytëzimi i tyre nga ana e anëtarëve të Kuvendit ka qenë për dy motive, njëra ka qenë për çështjen e e ambientit, pra që mos të shfrytëzohet letra në masë shumë të madhe, dhe tjetra ka qenë shkarkimi i administratës së Kuvendit nga puna e tepërt që kanë pasur për përgatitje të mbledhjes. Kërkoj nga drejtori i Administratës që këtë punë ta marrë përsipër, ta menaxhojë, nuk është shumë punë e madhe, mendoj që kryhet dhe funksionalizohet pa e dëmtuar ambientin me prodhim të gjithë asaj letre.

Leutrim Retkoceri theksoi se sa i përket çështjes së ngritur nga z. Sveçla për Ndërmarrjen Publike Banësore, konkretisht bëhet fjalë për një ndërtim aty dhe një kontratë që ka ndodhur në mandat dhe në përgjegjësi të bordit të kaluar. Është një temë e cila prej vitit 2016 sipas informacioneve që kemi, dhe në bazë të dokumenteve zyrtare që janë duke u përgatitur, pra është një çështje tashmë gjyqësore e hapur. Nuk e di çfarë logjike ka kur po trajtohet ajo lëndë në një seancë dhe në ndërkohë kërkohen masa pa lëvizë ende asgjë në atë drejtim, dhe problemi më i madh është aty që është shqetësim, sepse në kuadër të kësaj kauze është duke u rrezikuar diçka që është më e madhe se krejt ajo, pra është duke u rrezikuar interesi i ndërmarrjes dhe i qytetarëve kur po ndërtohen beteja dhe ato beteja po humben.

Ne si aksionarë i kemi marr hapat që është dashur me i marrë, kur në atë ndërmarrje kemi shkuar dhe kemi gjetur një bord, i cili nuk ka qenë i kompletuar dhe në kuadër të kompetencës tonë kemi vendosur ta emërojmë një bord të përkohshëm, në mënyrë që të vazhdojmë, për të mos mbetur ato pozicione vakante, kështu që kërkesa për të futur pikë të rendit të ditës për ta diskutuar nuk është e re sot që po e bënë LVV-ja, e kanë bërë në vazhdimësi krejt mandatin e kaluar. Kjo nuk është diçka e re, ndërsa shkarkimi i atij kryeshefi ka ndodhur për shkak të kompetencës së tij në menaxhim të asaj ndërmarrje dhe proceseve të tjera. Ne konsiderojmë se këto kërkesa janë të paqëndrueshme.

Lidhur me shqetësimin e ngritur nga z. Sveçla, si dhe për kërkesat dhe shqetësimet e parafolësve, sqarime të nevojshme dha Përparim Rama, kryetar.

Mbledhja përfundoi në orën 18:00.

Procesmbajtësi
Zijadin Gashi

Kryesuesi i Kuvendit
Fehmi Kapina



Faqe19nga19